

REFLEKSION LAUDATIV PËR MONOGRAFINË E LEONARD DAUTIT “GJEDHET E EPTIMIT FOLJOR NË GJUHËN SHQIPE”

Nga **Emine Sadiku**

Autori Leonard Dauti, studiues i njohur në fushën e gjuhësisë morfologjike, punonjës në Akademinë e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, botoi në vitin 2021 monografinë „Gjedhet e eptimit foljor në gjuhën shqipe“. Studimi u diskutua, u analizua në redaksinë përkatëse të Institutit të përmendur. Pasi u vlerësua nga zëra të njohur në fushën e gramatikës shqiptare (Albert Riska – redaktor shkencor, Ludmila Buxheli, Adelina Çerpja – recensues, dhe diskutues të tjerë), u botua me logon e veçantë, prestigjioze *asa*. Sot libri qarkullon në bibliotekat universitare, në libraritë tona dhe mund të përdoret nga kushdo që kërkon një informacion më shumë nga ai i prezantuar tashmë në gramatika të ndryshme të shqipes (kryesisht standarde).

Kaosi eptimor

Për të dhënë idenë e shumësisë së formave eptimore të klasave të ndryshme të fjalëve, që i nënshtrohen lakimit ose zgjedhimit në gjuhën tonë, sidomos të grupit të stërmadh, për nga format, të foljeve, po citojmë një fragment recensionit të autorit Klaus Steinke (në: *Digitales Rezensionsorgan für Bibliothek und Wissenschaft*) mbi librin „Albanisch – Fremdsprachengrammatik“: „Një detyrë herkuliane për çdo autor gramatikash të gjuhës shqipe është që pasurinë, bollëkun e formave t’i konceptojë në skema të qarta dhe t’ua paraqesë nxënësve dhe interesentëve në një formë të kuptueshme. Një shembull prototip për këtë vështirësi është folja, prezantimi i së cilës në librin e Teichmann (Albanisch – Fremdsprachengrammatik) ka zënë gjysmën e librit. Autorja grupon pesë zgjedhime, nga të cilët zgjedhimi i dytë përfshin gjashtë nënklasa. Është një reduktim, gjithsesi i fortë, krahasuar me grupet e dalluara nga Buchholz – Fiedler – Uhlisch në „Fjalorin e gjuhës shqipe“(Langenscheidt, 1977). Atje foljet janë grupuar në 53 tipa.“ ... Por a janë përfshirë të gjitha foljet e gjuhës sonë në këto trajtime? Është një pyetje që do të mbetet gjithnjë. Për problemin e grupimit të foljeve në zgjedhime autori Leonard Dauti del me teorinë e tij të 13 modeleve zgjedhimore. Kjo teori e “armatosur” me argumente, me shembuj, figura, grafikë e lista synon të jetë zgjidhja e problemit. Teoria ka shumë avantazhe krahasuar me zhvillime të tjera të së njëjtës fushë. Por, po t’i besojmë filozofisë së Wittgenstein -it : “Gjithçka, që ne arrijmë të përshkruajmë, mund të jetë dhe ndryshe...nuk ka rend apriori të gjërave ...” (Tractatus logico – philosophicus, SV, 1963, f. 91) mbetet gjithmonë diçka për t’u bërë. Kjo do të ishte sfida e zgjidhjes së problemit të propozuar në morfologjinë e eptimit foljor të L. Dautit.

Tematika

Autori zhvillon disa teori për të zbuluar e prezantuar objektin/objektet e veta. Teoritë e tij janë përshkrime të relacioneve empirike midis objekteve ose midis veçorive të këtyre objekteve që e nxjerrin në produktin final të studimit të tij *modelelet e zgjedhimit të foljeve në gjuhën shqipe*.

Monografia tematizon (nën)sistemin foljor të gjuhës shqipe, më konkretisht gjedhet e eptimit foljor. Brenda kësaj tematike autori ka përmbledhur e analizuar shumë çështje dhe probleme. Çështjet i parashtron dhe i shpjegon me mënyrën e tij tejet logjike dhe argumentative. Për problemet propozon zgjidhje, rrallë të njohura, shpesh të panjohura, që përmbajnë gjithnjë qëndrimin e tij, gjithnjë të arsytuar. Do të përmendnim këtu përjashtimin e kushtores nga sistemi foljor modal i shqipes (duke mospranuar dhe homoniminë: e ardhme në të shkuarën dhe kushtore: *do të punoja-dotë kisha punuar*). Megjithatë racionaliteti karakteristik nuk e largon krejt autorin nga ngjyrimi modal kushtor i konstruktit. Ai citon, ndër të tjerë, F. Agalliun

„Klasifikimi i këtij konstrukti si konstrukt modal është i përligjur. Edhe vlera modale e tij del e unifikuar; ai përdoret kryesisht me kuptimin modal të të presupozimit/hamendësimit... (f.61). Por, pasi sjell arsye të tjera, të vetat, ai përfundon: ...”Në vend që të flasim për një mënyrë të veçantë kushtore për shqipen, do të ishte më e saktë të flitej për konstrukte foljore modale-kohore që përdoren në konstruktin sintaksor kushtor, sipas modalitetit të veçantë të tyre”. (f. 61). Çështja e kushtores pasohet nga trajtimi i disa konstrukteve të tjera modale-kohore (f. 61 – 70). Pikënisja, qëllimi i një ndërmarrjeje të tillë, siç shprehet vetë autori nuk është për të shtuar edhe një klasifikim të ri në mozaikun tepër të pasur të klasifikimeve të deritanishme, por për të synuar drejt një zgjidhjeje sa më transparente dhe parashikuese, ku çdo foljeje të gjuhës sonë t’i gjendej vendi në tabelën përkatëse klasifikuese. Të shmangeshin zgjidhjet “ad-hoc”.

Mendoj që zemra e këtij materiali aq të ngjeshur, sa teorikisht – aq dhe metodikisht/metodologjikisht është “Modelet e zgjedhimit të foljeve në gjuhën shqipe”. Për të arritur në qendër të studimit autorit i është dashur të prezantojë, të sqarojë dhe të argumentojë teorinë e tij si dhe terminologjinë. Një moment tejet i rëndësishëm dhe kyç i punimit është „Tema foljore dhe eptimi i saj në gjuhën shqipe“ (f. 70 – 83). Që në nisje të kapitullit autori shpall se zgjedhimi i foljes ... është i analizueshëm mbi bazën e dy treguesve: eptimit të temës foljore dhe eptimit të mbaresave vetore. Brenda mendimit të njohur në këtë kuadër, raportit – temë foljore – mbaresë, ka plot qëndrime dhe nuanca të reja konceptore.

„*Revolucioni*“ në konceptimin dhe konceptet e L.Dautit

Duke lexuar shkrime të ndryshme gjuhësore të autorit L. Dauti shpesh jam befasuar me qëndrime, me pozicione krejt të reja gjuhësore. Intuitivisht i kam quajtur këto risi “revolucion”. Të tilla do të ishin disa përfundime në studimin mbi substantivimin e mbiemrave të gjuhës shqipe, në trajtimin e trajtave të shkurtra përemërore para disa foljeve, konceptim i ri i nyjave të përparme etj. Edhe në librin në shqyrtim nuk mungojnë “refuzimet” ndaj disa mendimeve të shkuara në çështjen e formave të eptimit të foljes në gjuhën tonë. Ndodh që autori të citojë, madje të analizojë mendime të gjuhëtarëve të ndryshëm për problemin e prezantuar, (citimet dhe referimet janë të shumta), por rrallë ndodh që L. Dauti të pajtohet tërësisht me përmbajtjen e materialit të citur (siç pajtohet me mendimin e gjuhëtarit gjerman H.J. Sasse). Dikur linja e ndjekur prej tij shmanget nga ato të njohura. Ai del në shtigje të reja. Të tilla risi në librin në fjalë do të ishin: *kundërvëniet kohore – aspekte në sistemin foljor të shqipes; Modaliteti dhe përfaqësimi i tij në zgjedhimin e foljes; tema e eptimit dhe tema bazë* etj. Por mbi të gjitha, risia kryesore është: *Modelet eptimore të sistemit foljor të shqipes; 13 modelet plus foljet atematike; foljet që dalin me paradigme të izoluar ...* Fillimisht është synuar të sqarohet statusi i elementeve të caktuara segmentore të pranishme në strukturën e foljes: *zgjeresit e temës dhe elementët kundër hiatit*. Së dyti, është synuar të bëhet dallimi i dy koncepteve qendrore për eptimin foljor: *temë eptimi dhe temë morfologjike* (f. 7). Mënyra e re e përshkrimit të modeleve eptimore të sistemit foljor të shqipes mbështetet në modelet tematike dhe në radhët e mbaresave. (Këtu krahas risive respektohet dhe mendimi i njohur: leksemat përbëjnë lista të hapura, ndërsa morfemat – grupe të mbyllura, i shprehur disi ndryshe.). Hierarkia e modeleve eptimore shfaqet si një risi tjetër: ndër dy modele, që kanë të njëjtën shtrirje, përparësi në renditje do të marrë ai model që është më prodhimtar në gjendjen e sotme të gjuhës (f. 118). Në paragrafin 3.2 “Tema foljore dhe eptimi i saj në gjuhën shqipe” (f. 71) autori ndalet veçanërisht në ndërrimet fonemore në trup ose në fund të fjalës, në të tashmen e dëftores. Ndërrimet që kanë ndodhur në temën e foljes, për rastet kur nuk janë të pranishme mbaresat vetore, janë parë si ndërrime me vlerë gramatikore. Në tekst citohet Boretzky: *marr – merr; dal-dal-dil* etj. (f.71). Autori vëren se jo të gjitha ndryshimet në zanoren e temës së foljeve të shqipes mund të konsiderohen si ndërrime fonemore. Në këtë kuadër autori dallon ndryshimet apofonike: *heq – hoqa, bredh – brodha ...* nga ato metafonike: *flas – flet; bërtas – bërtet...*

Sipas autorit ndryshimi i zanores tematike nuk është diktuar nga nevoja për diferencim formal në funksion të markimit të një vete të caktuar (f. 71). Vijoje dhe arsytimit të tjera për të ardhur në përfundimin : “Nuk mund të jetë ndërrimi fonemor mbartësi i një kuptimi të caktuar gramatikor...tema e përfutur është tipar klasifikues sipas të cilit njësi më të vogla bashkohen në njësi më të mëdha, ndërsa lloji i ndërrimit të tingujve është tipar diferencues mbi bazën e të cilit një njësi ndahet në njësi më të vogla...” (f.73) Në monografi operohet shpesh me termin *ligj – ligjësi*. Aftësia përgjithësuese – abstraguese e autorit lejon shpjegimet ku *ligji* dhe *ligjësia* shprehin raporte të sigurta kundërvëniesh . Por në gjuhë ka gjithmonë përjashtime që e relativizojnë kutimin dhe veprimin e ligjësi. Më së shumti mund të flasim për rregulla e rregullsi (f.80). Pozicione dhe momente origjinaliteti ka në shumë shtjellime para se të kalohet në modelet eptimore të sistemit foljor të shqipes që është risia më e madhe (e mbështetur sigurisht mbi qëndrime të shumta paraprake origjinale). *Me qëndrimet e tij autori e sfidon rregullisht mendimin e njohur gjuhësor*. Kapitulli II “Struktura morfologjike e foljes në gjuhën shqipe” me modelet e përvijuara të ndërrimit foljor shfaq shumë momente të një mendimi origjinal që ballafaqohet dhe kontraston me pikëpamjet e njohura në këtë domen: “Në këtë punim analiza e elementeve të sipërpërmendura, por edhe e konstrukteve sintetike dhe analitike të foljes në përgjithësi, pra, përcaktimi i njësisve morfologjike që marrin pjesë në ngjizjen e strukturës morfologjike, do t’i shmanget interpretimit të deritanishëm të kësaj strukture si lidhje sintagmatike, e bazuar në procesin e bashkimit segmentor të morfemave...Modeli i eptimit konceptohet si gjedhe kognitive.” (f.24) Edhe kapitujt e tjerë: 3, 4, 5 janë plot me ballafaqime me traditën morfologjike të eptimit foljor dhe gjithnjë spikat qëndrimi i ri i autorit mbi temat foljore- mënyrore; mbaresat e foljeve sipas mënyrave dhe kohëve, shpjegim i raportit të eptimi-radhe mbaresash etj. Terminologjia, ashtu siç paraqitet në monografi, është “një kantier” konceptesh të reja dhe rikonceptimesh. Në këtë punim nuk është kritikuar deri në mohim terminologjia e përdorur për emërtimin e kohëve gramatikore të gjuhës shqipe në gramatikat e derisotme. Por është zhvilluar një sistem i ri emërtimesh për shumë konstrukte foljore kohore-aspektore (shih: f. 10-12). Dallimi të morfologjike - temë e eptimit ka shërbyer si kriter i domosdoshëm për përcaktimin e modelit eptimor. Janë ripërkufizuar dhe terma të tillë si ‘formativ’ dhe ‘ndërmorfemor’.

Dukuria e listave vihet re gjithnjë e më shumë në gramatikat e ndryshme, shkencore, por sidomos në ato që shërbejnë për mësimin e një gjuhë si gjuhë të huaj. Në gramatikën e Akademisë (Tiranë, 2002), në atë të M. Çelikut (me bashkëautorë, Tiranë, 1998), në gramatikën Buchholz – Fiedler (Leipzig, 1987) etj. listat janë gjithnjë të pranishme. Në gramatikën time “Albanisch - Fremdsprachengrammatik”(Athena, 2019) ideja dhe principi i listave më ka shoqëruar në të gjitha klasifikimet dhe përshkrimet përkatëse, sidomos në grupimin e foljeve në zgjedhime, në klasa e nënklasa. Në çdo grupim a nëngrupim zgjedhimor foljor jam përpjekur të jap lista. Edhe pse konceptimet tona grupuese-klasifikuese në eptimin foljor ndryshojnë, (në fakt bëhet fjalë për dy gramatika të ndryshme nga tipologjia) është fakt se listat te L. Dauti janë më të gjata e më ambicioze. Kjo gjatësi, që synon gjithëpërfshirjen, është një risi e dukshme që sjell studimi i L. Dautit. Në këtë paragraf të risive nuk mund të le pa përmendur dhe punën e Leonardit në redaktimin dhe formatimin e librit tim “Albanisch - Fremdsprachengrammatik”. Unë e vija re se ai donte të ndërhynte në momente të caktuara teorike-empirike. Sistematikisht nuk e pranoja këtë për të mos dalë nga koncepti im. Po kur doli libri i tij (me të cilin po merrem sot), me pozicionet e tij origjinale, me thellësinë e analizave, e kuptova se ndërhyrja e tij nuk ishte aq e thjeshtë sa ç’ e kisha menduar unë. Ai më kërkoi të falur se kishte dalë në rrugë të tjera, të reja, të shumta, të ndryshme nga të miat. Por nuk ishte nevoja të më kërkonte të falur. Për mua ka qenë gjithnjë e qartë: nxënësi e tejkalon mësuesin.

Sistem versus inventar/përdorim

Pak më sipër folëm për veçantinë e përdorimit të listave krahas figurave, tabelave, të cilat, edhe pse, në pamje të parë, të befasojnë me mënyrën e tyre ndryshe, joshkimore, të prezantimit, janë lehtësisht të deshifrueshme. Autori vetë jep informacion të bollshëm për përfshirjen e grafikave etj. në receptimin e momenteve të ndryshme teorike. Kombinimi i tabelave me listat përkatëse e qartëson dhe e lehtëson marrjen e dijes mbi eptimin, modelet eptimore të një numri pa kufi foljesh. Duke përdorur përcaktimin „pa kufi“ kemi dalë në një truall tjetër, kemi braktisur sistemin dhe jemi hedhur në universin e shumësisë së panumërueshme të njësive gjuhësore. Këtë e dëshmojnë listat e gjata pas çdo prezantimi, edhe njëherë, të modeleve zgjedhimore. Është vështirë t'i trajtojmë listat si sistem në kuptimin e numrit të pacaktuar të elementeve përbërëse. Në nëntitull ne i kemi emërtuar me termin e njohur (edhe në gjuhësi, sidomos në atë parastrukturaliste) *inventar*. Po qe se autori do të dilte me pretendimin se listat e tij janë shteruese, ne do t'i përgjigjeshim: në faqen 122, në listën e foljeve të modelit të parë zgjedhimor mungon folja shumë e përdorur *lundroj*. Asnjëherë sistemet ose nënsistemet gjuhësore nuk kanë përfshirje/përbërje absolute të madhësive përbërëse. Po ta trajtojmë sistemin si një sasi elementesh dhe relacionesh midis tyre, ndoshta listat do të përbënin sistem. Por po ta shohim sistemin si një e tërë të përbërë nga pjesë të bashkëvendosura, vështirë të dallojmë kornizat e sistemit në lista të stërgjatura. Duke u nisur dhe nga raste të tilla, më saktë do të ishte të shprehemi: gjuhën e kemi konsideruar sistem. (shih për këtë dhe: Zarnikov, Annemarie, *Einführung in die Linguistik*, Frankfurt am Main, 1978, f. 5, 77). Sistemi tronditet sa herë që shfaqen përjashtime, si: *shkoj* – (aorist) *shkova* por *mbroj* – *mbrojta*; *laj* – *lava* por *mbaj* – *mbajta* etj. Ndërsa me përdorimin gjuha e braktis krejt sistemin për të hyrë në universin e ligjërit ku krahas materies gjuhësore luajnë një rol të rëndësishëm dukuri jo gjuhësore, si: *folësi*, *dëgjuesi*, *situata* dhe elemente të tjera - objekte shkencash fqinje me gjuhësinë. Gjithsesi tabelat aq të gjata, aq të pasura janë një informacion i bollshëm teorik, shkencor, një ndihmë e rrallë didaktike për të gjithë të interesuarit shqipfolës dhe për ata që duan të mësojnë shqip. Para botimit të monografisë së L. Dautit, edhe unë në gramatikën time “Albanisch - Fremdsprachengrammatik” i kam përdorur listat, si domosdoshmëri në shpjegimin dhe mësimin e shqipes si gjuhë e huaj, por foljet e listuara nëpër klasa e zgjedhime tek unë nuk e kanë asnjëherë sasinë dhe bollëkun që gjejmë te L. Dauti. Prej kohësh në mendimin tim gramatikor ka zënë vend ideja e *listës*, sidomos në klasifikimin e formave zgjedhimore foljore. Koncepti i *listës*, sigurisht, nuk ka të bëjë vetëm me foljen, ose me eptimin e pjesëve të tjera të ligjëratës, me gramatikën, me gjuhësinë në përgjithësi, por është e gjithëgjendshme në tërë sferat e veprimtarisë njerëzore. Përherë e më tepër vihet re përdorimi i listave të gjata në gramikat e botuara kohët e fundit, në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. Sa më e gjatë të jetë një listë, aq më e lodhshme, por dhe më e dobishme është ajo. Sidomos në kapitujt, që i kushtohen përshkrimit të gramatikës foljore, listat janë të pranishme dhe nganjëherë flasin më shumë se analizat teorike, ato e “ngrenë zërin” edhe kur analiza, shpjegimi teorik ka heshtur. Duke qenë se listat zënë një vend të spikatur në kapitullin qendror të punimit; duke dashur të praktikojmë dhe një lloj qasjeje didaktike ndaj kësaj vepre të mirëfilltë shkencore, po ndalemi disi më gjatë e më shumë në këtë dukuri argumentative, të dhënë me bollëk e tepri.

Ekskurs: a) *Logjika dhe estetika e listave*

Hartimi i katalogëve, regjistrimeve, listave lidhet ngushtë me nxitjen e brendshme, të përhershme të njeriut për të vendosur një rend e një rregull në jetën dhe në botën e tij; për të paraqitur si të fundme pafundësinë e dukurive dhe objekteve përreth. Sot shembulli më i mirë i renditjes, i listimit të gjërave, i pafundësisë “së fundme” është interneti. Listat përdoren jo vetëm në studime shkencore, si në rastin e monografisë në fjalë, por edhe në shumë fusha të

tjera. Përdorimit të tyre në botën e artit Umberto Eco i ka kushtuar një studim interesant të paraqitur në një libër voluminoz me titull “Unendliche Liste” (botimi gjermanisht: München, 2011). Dukurinë e listës autori e vrojton në letërsinë e shkruar, në pikturë, në skulpturë. Duke u marrë dhe me historinë e hartimit dhe përdorimit të listave autori kalon nga një epokë historike në një tjetër dhe jep shembuj argumentativë ku listat shfaqin jo vetëm domethënien logjike por edhe retorikën e tyre. Në parathënien e punimit Eco shprehet: “Ky kërkim listash përbën një eksperiencë tejet tërheqëse jo vetëm për materialin e përfshirë në punim, por edhe për atë që ka mbetur jashtë, që duhej të mbetej jashtë. Kështu fjala e fundit e këtij libri quhet *undsoweiter*, etj., e të tjera.” (f. 7) Në titullin “Die sichtbare Liste” (lista e dukshme) autori pranë listës e fjalëve me tablo të pikturuara ose skulptura ku spikat shumësia e elementeve dhe veçorive të tyre përbërëse. Listat me fjalë mund të komentohen me produkte të artit pamor. Ideja e listës, e pafundësisë gjendet dhe në pikturë, në skulpturë. Këtu sasi të dukshme dhe të parafytyrueshme njëkohësisht. Në librin e Eco-s jepen foto të shumë pikturave e skulpturave ku, ajo, që prezantohet, është vetëm një pjesë e vëllimit të pacaktuar të gjërave të tematizuara. Receptimi rrok gjithnjë dhe të pathënshmen. Në tabllonë “Dhjetëmijë martirët e malit Ararat” (1515, Venedig) të Vittore Carpaccio, interesentit i sugjerohet që ta zhvillojë më tej fragmentin e paraqitur, ta hedhë imagjinatën përtej kufijve të tablosë, të ngërthejnë idenë konkrete të sasive të prezantuara me parafytyrimin e sasive “të panumërueshme”. Një dallim interesant është dhe ai midis listave “praktike” dhe atyre “poetike”. Listat poetike përmbajnë zakonisht një sasi emërimesh/fjalësh, që referojnë ose jo në realitetin objektiv, që përmbushin një qëllim artistik, që synojnë (zakonisht) rreshtimin e attributeve të një objekti letrar-artistik. Ndodh që të prezantohet edhe një sasi objektesh – krijime të fantazisë (si në pamjen më poshtë: “Dhjetëmijë martirët e malit Ararat”).

Listat praktike kanë funksion referencial, referojnë në grupime reale dhe synojnë t’i shenjojnë ato, duke i numëruar. Nëse këto grupime nuk ekzistojnë, nuk do të hartoheshin lista të tilla. Ato kanë si qëllim përfshirjen e plotë të objekteve të vëzhguara, por jo gjithnjë është e mundur një gjë e tillë. Listat e hartuara nga L. Dauti në studimin e tij, edhe kur nuk mbarojnë me etj. (e të tjera), nuk mund të quhen shteruese. Ose mund t’i quajmë shteruese duke u nisur nga fakti që janë vjelë foljet në fjalorët më të rëndësishëm të gjuhës shqipe, 1980, 2006. Po a mund të numërohen foljet që gjëllijnë në një gjuhë, qoftë dhe çdo klasë tjetër fjalësh ? ?



“Dhjetëmijë martirët e malit Ararat” (1515, Venedig) e Vittore Carpaccio

b) *Retorika e numërimit*

Që nga Antikiteti është e njohur në retorikë lista e deklamuar ritmike e cila nuk ka si qëllim të japë sasi të shumta, por më tepër veçoritë e një objekti t’i prezantojë në masa të mëdha, me tepri, shpesh – vetëm nga dëshira për të theksuar me anë të numërimit. Format e ndryshme të listave, në përgjithësi, shprehin retorikisht dukurinë “dendësim”. Numërimi (enumeratio) është një mënyrë evidentimi racional dhe shprehësie emocionale. U. Eco, në librin e tij, sjell shembuj të përdorimit të listave për të ndërtuar figurën retorike të zgjerimit (amplifikatio), ku mendimi dhe afeksioni vijnë duke u intensifikuar, p.sh.: “Sa gjatë akoma, Catilina, do ta shpërdorosh durimin tonë? Deri kur do të tallet me ne marrëzia jote? Ku do të arrish me harbutllëkun tënd pa fre? ... (Eco, f. 134), (Pjesë nga fjalimi në Senat i Cicero-nit kundër Catilina-s më 7 nëntor, viti 63 para erës së re). Në çdo sekuencë, të organizuar në fjali pyetëse, thuhet diçka më shumë ose me më shumë intensitet. Mënyrat e lidhjes së elementeve të shkallëzimit (gradatio) mund të jenë asidete, pa mjete të posaçme lidhjeje, ose polisindete, me anë mjetesh të ndryshme lidhjeje që dalin para çdo gjymtyre në numërim. Një retorikë të veçantë përmbajnë listat e

quajtura “të pangopura”ku spikat kërkesa dhe dalldia për gjithnjë e më shumë elemente të renditura. Gjymtyrët e listës mund të paraqesin përmbajtje të ndryshme, por ekziston gjithsesi një fill që i mban të lidhur në një varg. Ky princip zotëron dhe numërimin e foljeve në listat e përfshira në librin e L. Dautit.

c) *E pathënshmjia*

Dukuria, koncepti i së pathënshmes ka angazhuar dijetarë fushash të gjithëfarshme, që e kanë vështruar atë në kënde të ndryshme duke dhënë gjithsesi një *topos* të përbashkët, një vendtakim pikëpamjesh, konceptesh. Autorët e gjendur para madhësive pa kufi, para sasive të panjohura për të cilat nuk mund të thuhet fjala e fundit, dikur heshtin dhe ia lënë lexuesit (fantazisë) të plotësojë. Mund të përmenden shumë shembuj *topos-i* të së *pathënshmes* në letërsi, që nga Homeri deri në ditët tona. Në poemën e tij “Odisea”ai shprehet: “Nuk mund të përmend ose t’i vë emër gjithçkaje që ka të bëjë me bëmat e guximshme të Odisesë...” (marrë në ‘Listat pakufi’ të U. Eco, München, 2011, f. 37). Ashtu si Homeri nuk mund t’i numërojë të gjithë ushtarët grekë, edhe Dante e ka të pamundur t’i emërojë engjëjt në qiell, jo se nuk ua di emrat, por se sasia e tyre është e panjohur për të, pra e pathënshme. U. Eco përmend në librin e tij shumë raste e shembuj dukurish të pafundme në letërsi e në art. Tepër interesant është ballafaqimi i shumësisë së paraqitur gjuhësisht: me lista në tekste, me atë të dhënë në arte pamore: në pikturë ose në skulpturë. Si në listat e teksteve gjuhësore ashtu dhe në pamjet e sasive të dhëna me art vizatimor ndodh që dukuria e dallueshme me sy të kthehet në vizion. Dikur aktivizohet imagjinata. Fillojnë të bashkëjetojnë ndërgjegjja perceptive me atë imagjinate. Ashtu si në veprat e arteve vizatimore, ajo, që jepet brenda kornizës, është veç një pjesë e së përgjithshmes, edhe në listat gjuhësore është vështirë të përfshihet e panumërshmja, e pafundmja. Wittgenstein do të thoshte për këtë: “Es gibt allerdings Unaussprechliches...es ist das Mystische...”(Sigurisht ekziston dhe e pathënshmjia ...ajo është mistikja.) (Wittgenstein, L. : Tractatus logico-Philosophicus, SV, 1963, f.115). Listat në librin e L. Dautit i përmbajnë njëkohësisht të numërueshmen e thënshme dhe të pathënshmen e vëllimeve sasiore pa kufi. Këto lista janë njëkohësisht argumente të teorive të autorit: kanë vlerë të madhe teorike; përbëjnë një ndihmesë të pasqorë praktike – didaktike; nxisin pambarim mendimin parafytyrues-krijues në lëmin e eptimit foljor; inkurajojnë vazhdimin e zgjatjes së tyre; zgjojnë interesin për gjetje sistemesh të tjera paralele. Së fundi çojnë në një heshtje të dobishme teorike – empirike. „Atje, ku nuk mund të shprehemi, duhet të heshtim“. Me këtë shprehje me vlerë aforizmi e mbyll librin e tij L. Wittgenstein. (“Wovon man nicht sprechen kann, darüber muß man schweigen.“ (Wittgenstein, L. : Tractatus logico-Philosophicus, SV, 1963, f.115) (Për atë, që nuk mund të shprehemi, duhet të heshtim.)

Pasthënie

„Unë zotëroj vetëm gjuhën e të tjerëve. Imja bën me mua çfarë të dojë“

(Ich beherrsche nur die Sprache der anderen. Die meinige macht mit mir, was sie will. Karl Kraus, në „Nachts“)

Këtë gjendje e kam provuar shpesh kur jam gjendur para tekstesh kompakte dhe të fortifikuar si ky i L. Dautit; tekste që më kanë sugjestionuar dhe për të cilët kam dashur të shprehem. Gjuha nuk më bindet gjithnjë. Vij vërdallë me formulime të ndryshme. Dhe më rri në mendje një nga thëniet e L. Wittgenstein-it: „Gjuha vesh mendimin në mënyrë të tillë që forma e jashtme e veshjes gjuhësore nuk mbulon krejt mendimin...Duhet shumë kompromise të heshtura, të komplikuar për të kuptuar shprehjen gjuhësore ... (L. Wittgenstein: *Tractatus logico-philosophicus*, edition Suhrkamp, 1963, f. 32)

Nuk më ndodh të shkruaj për tekste që s'i kuptoj. Shkruaj për tekste që i kuptoj shumë mirë. Informacioni i tyre trazon diçka tek unë, si lexuese bëhem pjesë e tekstit dhe merrem me vazhdimin ose përpunimin, ose thjesht vlerësimin e tij.

Kredoja ime shkrimore ka qenë vazhdimisht: Synimi dhe efekti të jenë në proporcion të drejtë. Por më ndodh të „profanizoj“ qëllimin duke prodhuar shprehje që japin një pamje të shfytyruar të mendimit. Dhe më duhet të shkruaj e të shprehem, të ushtrohem, deri sa të arrij një lloj identiteti, më saktë - proporcionaliteti midis gjuhës dhe mendimit, një veprim reciprok të gjuhës dhe qëllimit. Pathosi për një gjuhë sa më të përmbushur është pathos për një mendim sa më të plotë e të arsyeshëm. Lidhur me këtë, e për shkak të gjuhës, që ndonjëherë nuk më bindet, me siguri, i kam mbetur borxh vlerësimit të një libri monografik si ky i autorit L. Dauti. Do të më duhet t'i kthehem përsëri. E kam menduar dhe titullin e ri që është një thënie po e Wittgenstein-it “Kufijtë e gjuhës sime janë kufijtë e botës sime” (në *Tractatus logico-philosophicus*, SV, 1963, f. 90).

Scilicet id faciam (dhe do ta bëj)...

Kur një nga ish-nxënësit e mi më pyeti se ku mund të gjente një teori dhe një paraqitje të foljeve në gjuhën shqipe që do ta ndihmonte veçanërisht në një orientim të mjaftueshëm në kaosin e formave zgjedhimore foljore, unë i rekomandova pa ngurim „Gjedhet e eptimit foljor të gjuhës shqipe“ të Leonard Dautit.